



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal, Media dhe Zhvillim Rajonal  
Mbledhja nr. 69  
Prishtinë, më 10 shtator 2024, në orën:11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Isak Shabani, Fidan Jilta, Adelina Grainca, Nijazi Isaku, Besim Muzaqi, Mergim Lushtaku, Agim Veliu dhe Besnik Tahiri.

Mungoi: Fitim Haziri.

Në mbledhje morën pjesë: Faton Hamiti, Kallxo.com, Ekonomia online, KosovaPress.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

**Rend të ditës:**

- 1. Njoftim lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet KO232/23 dhe KO233/23;**

**Valon Ramadani**, njoftoi komisionin lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës në rastet KO232/23 dhe KO233/23 lidhur me Ligjin nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Si dhe konform nenit 91 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, kërkohet nga Komisioni funksional që në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të përgatisë tekstin e Ligjit nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pa nenet e shpallura të pavlefshme si në vijim: Neni 2, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Andaj, referuar nenit 91 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit dhe në përputhje me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, Ligji nr.08/L-180 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, procedohet për shpallje nga Presidentja e Republikës së Kosovës, sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.

**Isak Shabani**, shprehu shqetësim lidhur me thirrjen e mbledhjes vetëm me pikën e rendit të ditës edhe pse ka çështje të tjera që janë në procedurë për shqyrtim nga komisioni, fjala ishte për mocionin e grupit parlamentar të PDK-së, për të ftuar në raportim bordin e RTK-së, lidhur me publikim e lajmit “Slobodna Bosna” nga RTK për të cilin janë ngrit debate nga medime të ndryshme dhe organizata mediatike  
Pyetja e tij ishte pse nuk është thirr mbledhja për shqyrtimin e mocionit?

**Valon Ramadani**, u përgjigj, se konform Rregullores së Kuvendit në kohën e përfundimit të sesionit, Kuvendi nuk mban mbledhje, përveç në rastet kur ka kërkesa me 40 nënshkrime

**Isak Shabani**, lidhur me pikën e rendit të ditës, tha se Gjykata Kushtetuese me Vendim ka arsyetuar ankesën e Grupit parlamentar të PDK-së, se Ligji për KPMSHCK-në ka qenë kundërkushtetues.

**Agim Veliu**, meqë mbledhja e komisionit është mbledhje e rregullt, secili anëtar ka të drejtë të ngris edhe çështje të tjera për diskutim, duke përkrahur diskutimin e z. Isak Shabani për të ftuar Bordin e RTK-së në raportim.

**Valon Ramadani**, çdo çështje e ngritur jashtë pikës së rendit të ditës mund të shqyrtohet në pikën e rendit të ditës, të ndryshme.

**Mergim Lushtaku**, Qeveria në këtë mandat ka bërë disa shkelje kushtetuese, një ndër të cilat është edhe kjo, Gjykata Kushtetuese me Vendimet e veta po vërteton se ka shkelje të Kushtetutës.

Mbledhja përfundoi në orën: 11:40.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Valon Ramadani,**

**Kryetar i Komisionit**

---